



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:201955

Datë: 21.12.2021

Numri i dokumentit: 02538717

**P.nr.444/21**

**P.nr.540/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Sh. nga Gjakova, për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë PP/II.nr.1225/21 të datës 10.09.2021 dhe veprës penale dhe vjedhje e rende në vazhdimësi nga neni 315/1-1.1-77të KPRK-ës, sipas aktakuzës së PTH-DP në Gjakovë PP/II.nr 1177/21 të datës 22.10.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **16.12.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit B. Sh., me dt.20.12.2021, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. SH.** nga Gjakova, Rr "...", data e lindjes ..., i biri i T. dhe i nënës R. e gjinisë G., ka te kryer III kl të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, i divorcuar atë i 4 fëmijëve, egjiptian, shtetas i R. Kosovës, me nr. ID ...

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

**I.**

-me dt.19.06.2021, rreth orës 13:38/h, në Rr. "Skënderbeu", në Gjakovë, saktësisht në **dyqanin "...**", me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, këtu të dëmtuarit Y. K., në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar situatën e volitshme para derës së dyqanit i merr dy shtylla dekorative të metalta që shërbenin si shtylla sinjalizuese për hyrjen në dyqan, e pastaj të njëjtat i shet në hekurishten "...", ku pas një pune operative të Policisë, shtyllat dekorative sekuestrohen dhe i kthehet të dëmtuarit ne gjendje të papërdorshme, me ç' rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 70€.

**II.**

-me datë 09.07.2021 në ora 20:35 minuta, në shkollën e mesme "Kadri Kusari" në Gjakovë, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka marrë sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Arsim, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm derisa nuk ishte askush në objekt, shkon pas shkollës dhe përmes një objekti i cili ishte në ndërtim e sipër ngjitur me shkollën, hyn nga dera e pasme e cila nuk e ishte e mbyllur me qelës dhe pastaj me përdorimin e forcës e hap derën tjetër për të hyrë në shkollë e cila ishte e mbyllur me gozhdë, e më pas shkon në sallën e laboratorit të teknologjisë së ushqimit dhe aty i merr rreth 50-60 metra kablllo elektrike e pastaj largohet në drejtim të panjohur, me ç' rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 315 par.1 nënpar.1.1lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

**Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 , 72 par.1 nën.par.1.3 dhe 1.6, nenit 315 par.1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, të akuzuarin B. Sh. i shqipton :**

### **DËNIMIN ME BURG**

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **12 (dymbëdhjetë)** muaj si dhe :

Dënim me gjobë në shumë prej **100.00 (njëqind ) euro**, e të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me dhunë .

Nëse dënimi me gjobë në shumë prej 100,- (njëqind ) euro ,nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas neni 43 të KPRK-së, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **5(pesë ) ditësh** , duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet) €**.

Të dëmtuarit Y. K. nga Gjakova si dhe perf. i autorizuar u DKA në Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë ne emër të paushallit gjyqësorë shumë prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzat PP/II.nr.1225/21 të datës 10.09.2021 dhe PP/II.nr 1177/21 të datës 22.10.2021 , ka akuzuar të akuzuarin B. Sh. nga Gjakova , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së ,si dhe ë veprës penale të vjedhje e rende nga neni 315 par 1 nën par. 1.1 të KPRK-së , duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 16.12.2021, ka vendosur sipas propozimit të akuzuarit dhe pëlqimit të prokurorit t për bashkimin e lëndëve penale dhe atë: P.nr. 444/21 dhe P.nr.540/21 dhe zhvillimin e përbashkët te procedurës penale për këto 2 lëndë penale dhe pajtimit të prokurorit të shtetit ,ka bërë bashkimin e këtyre 2 lëndëve penale dhe shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me **numër unik P.nr.444/21**.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.16.12.2021 , përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë Prokurori Anton Hasanaj ,lexon aktakuzat PP/II.nr.1225/21 të datës 10.09.2021 dhe PP/II.nr 1177/21 të datës 22.10.2021 , me ç ‘rast prokurori pas leximit te aktakuzave deklaroi se me qene se gjykata ka aprovuar propozimin për bashkimin e lendeve dhe ndaj te pandehurit do te zhvillohet një procedura e vetme ,pasi kam analizuar dhe vlerësuar veprat penale përkatësisht kohen dhe rrethanat ne te cilat janë kryer veprat penale vlerësoje se janë plotësuar kushtet nga neni 77 i KPRK-ës ,dhe atë dashja e njëjtë e kryesit dhe shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies se njëjtë kohore ,ashtu qe sa i përket te pandehurit B. Sh. e bënë përmirësimin –plotësimin e kualifikimit juridik ku i njëjti për këto aktakuza për veprën penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së dhe vjedhje e rënd nga neni 315 par.1 nën.par.1.1 të KPRK-së duhet te jetë :me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e rende ne vazhdimësi nga neni 315par.1 nën.par.1.1 lidhur me nenin 77 te KPRK-ës , ndërsa pjesa tjetër e aktakuzave mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari B. Sh. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprat penale me të cilat pandehet sipas aktakuzave duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprat e kryera për shkak të gjendjes së dobët ekonomike me qene se jam mbajtes i vetëm i familjes time 5 anëtarësh e pa ashtu kujdesem edhe për familjen e vëllai i cili është ne vuajtje te dënimit prej 6 anëtarëve ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet kërkim faljen nga te dëmtuarit për demin e shkaktuar , andaj i propozoi gjykatës qe te marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme ,kërkim falje nga të dëmtuarit, gjendjen e dobët ekonomike te me shqiptojë një dënim me te butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuarit B. Sh. , i cili pranim ka mbështetje te plote ne provat te cilat gjenden ne shkresa te lendes, andaj vlerësojë se ky pranim është ne pajtim me dispozitën e nenit 248 te KPPK-ës, andaj i propozoi gjykatës te njëjtin ta shpall fajtor ,ta dënojë konform ligjit duke marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë renduese dhe njëherë te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. Sh. : **I.** --me dt.19.06.2021, rreth orës 13:38/h, në Rr. “Skënderbeu”, në Gjakovë, saktësisht në dyqanin “. . .”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, këtu të dëmtuarit Y. K., në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar situatën e volitshme para derës së dyqanit i merr dy shtylla dekorative të metalta që shërbenin si shtylla sinjalizuese për hyrjen në dyqan, e pastaj të njëjtat i shet në hekurishten “. . .”, ku pas një pune operative të Policisë, shtyllat dekorative sekuestrohen dhe i kthehet të dëmtuarit ne gjendje të papërdorshme, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 70€. dhe **II.** -me datë 09.07.2021 në ora 20:35 minuta, në shkollën e mesme “Kadri Kusari” në Gjakovë, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka marrë sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Arsim, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm derisa nuk ishte askush në objekt, shkon pas shkollës dhe përmes një objekti i cili ishte në ndërtim e sipër ngjitur me shkollën, hyn nga dera e pasme e cila nuk e ishte e mbyllur me qelës dhe pastaj me përdorimin e forcës e hap derën tjetër për të hyrë në shkollë e cila ishte e mbyllur me gozhdë, e më pas shkon në sallën e laboratorit të teknologjisë së ushqimit dhe aty i merr rreth 50-60 metra kablo elektrike e pastaj largohet në drejtim të panjohur, me ç ‘rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material.-**me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 315 par.1 nënpar.1.1-77 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit B. Sh., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i katër fëmijëve ,në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme ,si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës për veprat penale për të cilat ngarkohet, pendimin e thellë të akuzuarit për veprat penale të kryera duke iu kërkuar publikisht falje palëve të dëmtuara ,faktin se është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, kujdeset për 5 fëmijët e tij si dhe 6 anëtarëve të familjes së vëllait të tij . Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti edhe me parë është i dënuar me dënim për vepra penale të natyrës së njëjtë. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera posaçërisht rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 70 të KPRK-së dhe ka aplikuar dispozitën e nenit 72 par.1 nënpar.1.3 dhe 1.6 të KPRK-së kur ka shqiptuar dënimin me burgim nën kufijtë e përcaktuar me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për të akuzuarin, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së me bindje se ky dënim të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimit të ligjit .

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 te KPP-ës, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur që ta saktësojë lartësinë e dëmit që i akuzuari iu ka shkaktuar te dëmtuarve pasi që nuk ka asnjë ekspertize apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar .

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.444/21 dhe P.nr. 540/21 datë 20.12.2021**

**Sekretarja juridike  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a  
Ilijana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej 15 ditësh ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:201955  
Datë: 21.12.2021  
Numri i dokumentit: 02538717